



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Më datë 04.09.2014, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Frëngovë. MPN-ja realizoi vizitë të paparalajmëruar në stacionin policor për mbikëqyrje kufitare me qëllim të përcaktimit të gjendjeve dhe kushteve në vendet ku personat privohen nga liria dhe trajtimit të tyre. Gjatë vizitës së Stacionit Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Frëngovë u zhvillua bisedë me administratorin dhe nëpunësin policor kujdestar të SP dhe më pas u bë këqyrje në ambientet e stacionit policor, si dhe u bë këqyrje mbi evidencën për personat e privuar nga liria.

SP për mbikëqyrje kufitare nuk është caktuar në përputhje me Aktvendimin si stacion policor ku ndalohen personat e privuar nga liria. Duke i marrë parasysh autorizimet të cilat i ka ky stacion kryen mbikëqyrje dhe bën sigurimin e linjës kufitare. Stacioni policor për mbikëqyrje kufitare është i vendosur në dy baraka, me ç'rast në njërin barakë gjendet zyra e kujdestarisë, administrata dhe zyrat e komandantit dhe ndihmës komandantit, ndërsa në barakën tjetër ka ambiente për qëndrimin e nëpunësve policorë derisa ata janë në detyrë. Ekipi i MPN-së gjatë vizitës së disa ambienteve, në të dy objektet e stacionit policor, nuk vërejtí sende të dyshimta, përkatësisht mjete me të cilat mund të kryhet shtrëngimi.

MPN-ja u njoftua se personat çdoherë informohen për të drejtat e tyre dhe kjo ndodh në momentin e privimit në stacionin policor. Në përputhje me informatat e pranuar nga nëpunësit policorë, në rast të privimit nga liria, personi çdoherë njoftohet me shkaqet e privimit dhe udhëzohet për të drejtat e tij, si dhe i sugjerohet e drejta e mbrojtësit. Komunikimi me personat e privuar nga liria, të cilët janë shtetas të huaj, bëhet në gjuhën angleze ose gjuhën shqipe.

Marrë në përgjithësi, SP për Mbikëqyrje Kufitare në Frëngovë e mban me rregull dokumentacionin për personat e privuar nga liria, me ç'rast në çdo dosje përmbaheshin dokumentet përkatëse. Në numrin më të madh të dosjeve të kontrolluara kishte rrjedhë logjike të ngjarjeve me të cilën saktësisht përcaktohet koha e arrestimit, udhëzimit me të drejtat gjatë kohës së privimit nga liria.

Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi raport të veçantë për realizimin e vizitës në të cilin u konstatuan gjendjet pozitive dhe negative dhe u dhanë rekomandime përkatëse adresuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe për komandantit të Stacionit Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Frëngovë.